



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 03/11/2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 02/11/2020 të parashtruar nga *O.E N.T.P "Lulishtja Buçaj"*, Gushtericë e Ulët lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Furnizimi dhe mbjellja e drunjve dekorativ në qytet dhe fshatra me nr te prokurimit 613-20-5899-121** nxjerr këtë ;

VENDIM

Aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim, e parashtruar nga *O.E Lulishtja Buçaj* pjesëmarrës në tenderin me titull: *O.E Lulishtja Buçaj*

Anulohe Vendimi i AK për dhënien e kontratës të publikuar me datë: 27/10/2020 dhe kthehet lënda në Rivlersim;

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik N.T.P "Lulishtja Buçaj", Gushtericë e Ulët lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Furnizimi dhe mbjellja e drunjve dekorativ në qytet dhe fshatra me nr te prokurimit 613-20-5899-121**, me datë 02/11/2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e lartëpërmendur. Autoriteti Kontraktues, me datë 03/11/2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Tenderi i operatorit të rekomanduar për kontratë është vlerësuar me kujdes dhe gjatë vlerësimit AK ka zbatuar me përpikëri dispozitat nga LPP dhe rregullat e nxjerra nga KRPP përveç që gjatë dorëzimit të Vërtetimit të ATK- ë nga operatorit të rekomanduar për kontratë i cili ka sjellë vërtetimin i cili nuk i plotëson kushtet e tenderit pasi që është Vërtetim për aplikim për vizë e jo për aplikim për tender .

Sa i përket pretendimit të parë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka sjellë Çertifikatën e numrit fiskal kjo nuk është arsye për refuzim të një tenderi sepse me Nr e ri ARBK këto dy Certifikata janë unisuar , dmth numri fiskal dhe nr Regjistrimit të biznesit janë të njëjt.

Sa i përket pretendimit të dytë se ofertuesi ka ofruar pa ne llogaritur TVSH-në edhe ky pretendim nuk qëndro sepse në kushtet e përgjithshme të kontratës neni 12 precizohet se Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për pagesën e të gjitha taksave, detyrimeve të pullës, taksat e licencave, tarifat doganore dhe taksat tjera që lindin apo imponohen deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuara në vendin e dorëzimit, siç është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Sa i përket kërkesës një ing i diplomuar Drejtimi pentari -vreshtari , operatori i rekomanduar për kontratë ka ofruar diplomën , CV dhe një kontratë për këtë projekt dhe është plotësuar kushti sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues.

Sa i për ketë listës së kontratave Autoriteti kontraktues duhet të kërkojë sqarim sa i përket datës së fillimit dhe përfundimit të kontratave të paraqitura sepse operatori i rekomanduar për kontratë ka sjellë referencat dhe listën për kontratat e nënshkruara por kjo listë nuk është e plotë.

Sa i përket pretendimit se operatori i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kushtin për mjetet e punës siç është cekur në kërkesën për rishqyrtim nuk qëndron për arsye se ekskavatori nuk është kërkuar me fuqinë por vetëm eskavator e mendojmë se të njëjtin funksion e kryen edhe mini eskavatori se ka me hap gropa për mbjelljen e drunjve .

Për pretendimin se operatori i rekomanduar për kontratë nuk ka sjellë certifikata për prejardhjen e drujve nuk qëndron sepse kjo nuk është kërkesë për vlerësim, por gjatë implementimit të kontratës do të kërkohej këto dokumente dhe nuk do të pranohen drujtë nëse kontraktuesi nuk i paraqet [prejardhjen e tyre](#).

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Adem Duriqi

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit